



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 851
Dt 30.05.2018

Në bazë të nenit 38, lidhur me nenin 32, pika 2.1 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2018, në mënyrë unanime, mori:

VENDIM

Për iniciimin e procedurës për shkarkimin e prof. ass. dr. Rifat Morina nga pozita e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2018, ka diskutuar çështjen e funksionimit të Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim të Cilësisë, duke shprehur kritika të mëdha ndaj punës dhe veprimtarisë së prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë. Kritikën nga anëtarët e Senatit janë shprehur kryesisht në raport të ndërprerjes së plotë të bashkëpunimit mes tij dhe strukturave udhëheqëse të Universitetit, si dhe injorimit të plotë të organeve të UMIB-it nga ana e tij. I njëjti ka pasur qasje të papërgjegjshme edhe gjatë procesit të riakreditimit të programeve të studimit të UMIB-it në vitin 2017.

Senati, gjithashtu, ka konstatuar se ekziston një përkeqësim-ndërprerje e raporteve të bashkëpunimit mes prorektorit të lartcekur dhe udhëheqësve të njësive akademike të Universitetit, gjë që ka reflektuar dhe po reflekton negativisht në fushëveprimtarinë e këtij institucioni universitar.

Senati i Universitetit konstatoi se fryma jo e mirë e bashkëpunimit midis strukturave kyçe udhëheqëse në Universitet dhe të prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë nuk i ndihmon zhvillimit akademik të Universitetit në përgjithësi.

Bazuar në këto që u cekën më lartë, Senati i Universitetit, në mënyrë unanime, (pa asnjë votë kundër), mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi duke i rekomanduar Këshillit Drejtues marrjen e vendim-propozimit për shkarkimin e prof. ass. dr. Rifat Morina nga pozita e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (neni 15 i Rregullores mbi punën e Këshillit Drejtues).

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB – it,
2. Këshillit Drejtues të Universitetit;
3. Rektorit të Universitetit;
4. Të përmendurit



Prof. asoc. dr. Alush Musaj
Kryesues i Senatit